



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:010254

Datë: 15.04.2024

Numri i dokumentit: 05573282

C.nr.83/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtari Bekim Salihu, në çështjen juridike të paditësit S.B. nga fshati R., Komuna Shtime, të cilën me autorizim e përfaqëson av.Nazmije Ibrahimimi nga Ferizaj, kundër të paditurave Komuna Shtime dhe KRU “Prishtina”, për kompensim dëmi, jashtë seancës me 15.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia e paditësit S.B. nga fshati R., Komuna Shtime, kundër të paditurave Komuna Shtime dhe KRU “Prishtina”, për kompensim dëmi.

A r s y e t i m i

Paditësi, përmes të autorizuares së tij, kundër të paditurave, ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datën 21.01.2021, për kompensim dëmi.

Gjykata, me 28.02.2024, ka pranuar parashtresën nga paditësi, lidhur me tërheqjen e padisë dhe ka njoftuar se këtë çështje nuk dëshirojnë të vazhdojnë me këtë procedurë për çka kërkuar tërheqjen e padisë dhe ka shtuar se nuk kërkon aktvendim të veçantë.

Andaj, duhet konsideruar se padia në këtë çështje është tërhequr, nga arsyet e theksuara më lartë, gjykata parashtresën për tërheqjen e padisë, e ka aprovuar pa shqyrtim gjyqësor të çështjes nga se i njejtë ka qenë i pa nevojshëm pasi që të paditurat e kanë pranuar parashtresën e paditësit dhe në afatin ligjor nuk është deklaruar andaj duke u mbështetur në nenin 261.2 të LPK-së merr aktvendim me të cilin **konstatohet se është tërhequr padia.**

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.83/21, me datën 15.04.2024

**Gjyqtari,
Bekim Salihu**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa – bazuar në nenin 261 par .4 i LPK-së.